

TRAJNIMI GJYQËSOR

NJË PERSPEKTIVË NGA KOSOVA



Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute

2013

////////////////////////////////////
Publikuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës

© IGJK 2013, Të gjitha të drejtat e rezervuara

Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK).

////////////////////////////////////
A U T O R Ë :

Lavdim Krasniqi
Suzana Pllana
Besim Morina
Valon Jupa

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	Pse trajnimi gjyqësor?.....	6	8.2.3.	Struktura e Programit të Trajnimit Fillestar	26
2.	Çka mund të përfitojmë nga trajnimi gjyqësor?	8	8.2.4.	Numri i kandidatëve që kanë diplomuar në PTF	28
3.	Instituti Gjyqësor i Kosovës dhe trajnimi gjyqësor	10	8.3.	Programi i Trajnimeve për Avancim	29
4.	Struktura udhëheqëse	12	8.3.1.	Cilat fusha mbulohen nga PTA?	30
5.	Burimet Njerëzore.....	14	8.3.2.	Trajnimet e realizuara në PTA 2010 - 2013	30
5.1.	Organizimi strukturor.....	14	8.4.	Programi për Hulumtime dhe Publikime.....	30
6.	Buxheti.....	16	8.4.1	Publikimet	32
7.	Organizimi i Trajnimeve.....	18	8.5.	Trajnimi i profesionistëve të sistemit gjyqësor e prokurorial	33
7.1.	Kush përfiton nga trajnimet	18	8.6.	E-learning	34
7.2.	Identifikimi i nevojave për trajnime.....	19	8.7.	Trajnimet dhe programet jashtë vendit	35
7.3.	Pjesëmarrja në trajnime	20	8.8.	Metodologjia e trajnimeve	35
7.3.1.	Mënyrat e pjesëmarrjes në trajnime të vazhdueshme dhe për avancim	20	8.9.	Trajnuesit (përzgjedhja e tyre)	35
7.3.2.	Aplikimi online	20	9.	Bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë dhe jashtë saj	36
7.4.	Ftesa për pjesëmarrje në trajnim të vazhdueshëm.....	21	10.	Donatorët	37
7.5.	A paguhet për trajnime?.....	21	11.	Idetë për përmirësimin e programeve apo nevoja për publikim	38
8.	Struktura e trajnimeve	22		Kontakti	
8.1.	Trajnimi i vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë.....	22			
8.1.1.	Cilat fusha mbulohen nga PTV?.....	24			
8.1.2.	Aktivitetet e realizuara në PTV 2000 - 2013	24			
8.2.	Programi i Trajnimit Fillestar	25			
8.2.1.	Kush mund të ndjek trajnimin fillestar?.....	26			
8.2.2	Provimi Përgatitor si kusht për të ndjekur trajnimin fillestar	26			

**“Ti duhet
të jesh
ndryshimi,
të cilin
dëshiron
ta shohësh
në botë”**

Mahatma Gandhi

1 PSE ? TRAJNIMI GJYQËSOR ■

Në ditët e sotme, në çdo vend të botës gjyqësorit i kushtohet një vëmendje e veçantë për faktin se ai konsiderohet si garantues absolut i funksionimit demokratik të institucioneve dhe mbrojtës i lirive dhe të drejtave të njeriut. Në këtë frymë duket të jenë edhe shumica e angazhimeve të aktorëve të sistemit të drejtësisë në vendin tonë.

Arritja e këtyre vlerave mund të pretendohet vetëm përmes forcimit të pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë të sistemit gjyqësor e prokurorial. Pavarësia dhe paanësia si vlera dhe si shtylla të gjyqësorit mbi të cilat do të jetësohej besimi i publikut ndihmohet përmes krijimit të mekanizmave ligjor që mundësojnë një proces të rekrutimit transparent, të drejtë dhe të barabartë të gjyqtarëve e prokurorëve si dhe ngritjen e tyre të vazhdueshme profesionale

në mënyrë që të jenë në gjendje të ushtrojnë funksionet e tyre të mbështetur vetëm në ligj. Pavarësia dhe paanshmëria si vlera themelore të gjyqësorit ndërtohen jo vetëm përmes mekanizmave të tillë por edhe duke siguruar zbatimin e përgjegjësive etike për gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë të sistemit gjyqësor e prokurorial.

Një ndikim të rëndësishëm drejt njohjes dhe ngritjes së vetëdijes në respektimin e këtyre parimeve dhe vlerave në gjyqësor ka trajnimi fillestar dhe i vazhdueshëm i gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të cilët pretendojnë të bëhen gjyqtarë apo prokurorë. Përmes këtyre trajnimeve fitohen, mbahen e zhvillohen aftësi dhe shkathtësi të shumta profesionale dhe etike.

Trajnimet fillestare dhe të vazhdueshme tashmë si në shumë vende të botës edhe në Kosovë nuk janë vetëm e drejtë por edhe obligim. Krijimi i nivelit që sot ekziston rreth trajnimit, ka filluar dhe vazhdon të përcillet me rregullime ligjore si në nivelin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtarë ku sot ekzistojnë instrumente të ndryshme dedikuar kësaj çështjeje. Ndër ato, më të njohurat janë; Principet Bazë të KB-së për Pavarësinë e Gjyqësorit (1985), Rekomandimi Nr. R (94) 12 i Këshillit të Evropës (1994), Karta

Evropiane për Statutin e Gjyqtarit (1998), Opinioni Nr. 4 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian (2003), Programi i Stokholmit (2008 – 2010).

Përpjekjet për të zbatuar një trajnim gjyqësor i cili siguron vlerat e synuara edhe me dokumente ndërkombëtare, në Kosovë, më së miri ka arritur ti realizojë Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK).



2 ÇKA

MUND TË PËRFITJMË NGA TRAJNIMI GJYQËSOR

Kësaj pyetjeje do të mund ti përgjigjemi lehtë nëse e dimë përgjigjen e pyetjes “për çka duhet të jenë kompetent gjyqtarët, prokurorët dhe profesionistët tjerë të sistemit gjyqësor e prokurorial” në një vend. Nuk ka dilemë se ndër kompetencat e tyre kryesore janë ato të llojit profesional, etik dhe interdisiplinar. Kompetencat profesionale, etike dhe interdiciplinare të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë të sistemit të drejtësisë, pas studimeve bazike universitare, mund të fitohen, mbahen dhe zhvillohen vetëm përmes ndjekjes së trajnimeve të ndryshme. Trajnimet si ato fillestare dhe të vazhdueshme ndihmojnë ngritjen dhe zhvillimin e shkathtësive dhe aftësive të cilat mundësojnë përgatitjen e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe mbështesin të emëruarit si gjyqtarë apo prokurorë që të përballen me sfidat e

drejtësisë të shekullit XXI të përcjella me shumë ndryshime shoqërore, ekonomike e kulturore.

Trajnimet për kategoritë e profesionistëve gjyqësor janë të llojllojshme, duke filluar me ato të karakterit të pastër profesional për të vazhduar me trajnime të karakterit inter-disiplinar përmes të cilave ngriten aftësi e shkathtësi inter-personale. Trajnimet e tilla janë garancion i fuqishëm i pavarësisë, paanësisë dhe vlerave të cilat duhet ti posedojë një gjyqtarë, prokurorë dhe profesionist tjetër i sistemit gjyqësor. Ky nivel i gjyqësorit është i domosdoshëm për të zbatuar jo vetëm ligjet vendore por në radhë të parë kërkesat e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat dhe Liritë Themelore, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare.

Përgjigja e pyetjes se çka në të vërtetë përfitohet nga trajnimi gjyqësor duhet shoqëruar me përpjekje serioze për të identifikuar nevojat për trajnim, duke hartuar programe adekuate, përfshirjen në trajnim të pjesëmarrësve adekuat dhe duke zbatuar metodologji përkatëse trajnimi. Ky proces mjaft sfidues më në fund do ta kishte një përgjigje të saktë të pyetjes se çka mund të përfitojmë nga trajnimi gjyqësor, pas zbatimit të mekanizmave vlerësues të efektit të trajnimeve në praktikë.

Në ditët e sotme pyetja rreth përfitimeve nga trajnimi duhet të gjejë përgjigje jo vetëm në institucionet që organizojnë trajnimin gjyqësor, por edhe në ato që përfitojnë nga trajnimi.

Në pyetjen se çka përfitohet nga trajnimi gjyqësor është duke dhënë përgjigje të vazhdueshme kontributi i IGJK-së dhe këtë më së miri e tregojnë rezultatet konkrete në praktikë.



3

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS DHE TRAJNIMI GJYQËSOR



Krahas Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës të cilët janë përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e gjykatave dhe prokurorive, pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës është edhe Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK).

IGJK është themeluar në vitin 2000 nga Misioni i OSBE-së në Kosovë. Fillimisht ishte ideuar si një sektor i trajnimeve në kuadër të OSBE-së. Gradualisht, nevoja për trajnime dhe roli që IGJK luajti në zhvillimin profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bënë që këtij institucioni t'i jepet primati kryesor për trajnime gjyqësore në vend.

Në vitin 2006, Kuvendi i Kosovës me ligj të veçantë e themeloi IGJK-në si një institucion të pavarur dhe kryesor për trajnime gjyqësore në vend. Sipas ligjit IGJK është institucion kryesor përgjegjës për trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve, kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë si dhe profesionistëve të tjerë të identifikuar nga vet IGJK. Përveç trajnimit IGJK ka përgjegjësi edhe kryerjen e aktiviteteve të karakterit kërkimor për zhvillimin e gjyqësisë në vend.

Për 13 vite të funksionimit, IGJK, ka arritur që me sukses të zbatojë mandatin e tij. Programet e



ndryshme trajnuese të IGJK-së jo vetëm që mbulojnë të gjitha fushat e së drejtës, por trajtojnë edhe aspekte të ndryshme jashtë jetës ligjore, me qëllim të ngritjes profesionale dhe forcimit të shkathtësive e vetive interdisiplinore të përfituesve të vet. Gjatë kësaj periudhe mbi një dekadë, IGJK ka arritur që me sukses të organizojë pesë herë provimin përgatitor për kualifikim të kandidatëve për gjyqtarë e prokurorë, ka zhvilluar me sukses programin e trajnimit fillestar për katër gjenerata të kandidatëve për gjyqtarë e prokurorë duke përfshirë pilot projektin e trajnimit fillestar në vitin 2005 dhe ka organizuar trajnime të vazhdueshme dhe për avancim të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë nga lëmi i gjyqësisë.

Roli i IGJK-së, në sistemin gjyqësor e prokurorial është i pamohueshëm, ndërsa përvoja e fituar ndër vite e bën atë të jetë ndër

institucionet kryesore në mbështetje të reformave të sistemit gjyqësor e prokurorial në Kosovë. Kjo mbështetje e lidhur kryesisht me ngritje të kapaciteteve edhe sot vazhdon të mbetet një sfidë me të cilën po përballen autoritetet e IGJK-së. Përvojat pozitive të IGJK-së kanë bërë që sot të jetë një institucion i respektuar si nga autoritetet vendore, po ashtu edhe nga organizatat ndërkombëtare dhe institucionet e natyrës së njëjtë që veprojnë në nivelin ndërkombëtarë.

Të arriturat e IGJK-së kanë iniciuar idenë e zgjerimit të aktiviteteve të këtij institucioni në mbështetje të profesionistëve të tjerë sipas kërkesës së tyre dhe me kushte të caktuara. Ky zgjerim aktualisht është duke u shoqëruar me diskutimet për reformim të trajnimit gjyqësor në Kosovë. Të arriturat pozitive të deritashme të IGJK-së janë bazamenti kryesor i çdo avancimi të mëtejshëm.



4 STRUKTURA UDHËHEQËSE



Ligji për Themelimin e IGJK-së, si organe më të larta drejtuese përcakton **Këshillin Drejtues** dhe **Drejtorin** e IGJK-së.

- **Këshilli Drejtues** i IGJK-së, sipas ligjit ka një përfaqësim të gjerë të institucioneve të gjyqësisë, prokurorisë, qeverisë dhe institucioneve të tjera vendore e ndërkombëtare, përfshirë edhe përfaqësimin etnik. Kjo përbërje jo vetëm që ka arritur të sigurojë një përfaqësim gjithëpërfshirës dhe të drejtë të interesave të akterëve të drejtësisë në Kosovë lidhur me trajnimin gjyqësor, por edhe ka garantuar pavarësinë e IGJK-së në funksion të interesit më të mirë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në vend.

Përgjegjësitë kryesore të Këshillit Drejtues janë të caktuara me ligj dhe përfshijnë; miratimin e programeve trajnuese, zgjedhjen e drejtorit, miratimin e statutit, projektbuxhetit dhe miratimin

e metodologjisë së trajnimit të bartësve dhe bartësve potencial të funksionit gjyqësor. Përgjegjësi të tjera janë caktuar me Statutin e IGJK-së.

- **Drejtori** i IGJK-së është përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të IGJK-së. Përgjegjësitë kryesore të drejtorit janë caktuar me ligj dhe me statutin e IGJK-së.

- **Këshilli Programor** si një mekanizëm i veçantë brenda IGJK-së, është organ ndihmës i Këshillit Drejtues. Përbërja dhe kompetencat e Këshillit Programor janë të caktuara me statut dhe kryesisht kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e programeve trajnuese dhe aktiviteteve për zhvillim të kapaciteteve që zhvillon IGJK. Këshilli Programor i IGJK-së i zhvillon aktivitetet e tij në bashkëpunim me gjyqësorin dhe prokurorinë e vendit.



5 BURIMET NJERËZORE

Një komponentë e rëndësishme e IGJK-së është ajo që ka të bëjë me burimet njerëzore (personelin). Personeli i IGJK-së përbëhet nga pjesa që lidhet me zbatimin e drejtpërdrejt të trajnimeve si dhe pjesa që ka të bëjë me funksionimin e administratës, financave dhe prokurimit. Përgjegjësitë e stafit që lidhet me zbatimin e programeve trajnuese kanë të bëjnë me identifikimin e nevojave, hartimin dhe zbatimin e programeve trajnuese. Ndërsa stafi i administratës, financave dhe prokurimit mbështet të gjitha funksionet e IGJK-së nga perspektiva e tyre. Numri i të punësuarve në IGJK aktualisht është 24, me ç'rast 19 prej tyre janë me kualifikime të larta universitare. Mbi 50% e stafit të IGJK-së kanë të

përfunduara studimet post-diplomike ose janë në proces të finalizimit të tyre në fusha të ndryshme, kryesisht ligjore.

5.1. Organizimi strukturor

Struktura organizative e stafit të IGJK-së është e thjeshtë dhe e konstruktuar të jetë në shërbim të zbatimit të funksioneve të IGJK-së. Secila pozitë e personelit i ka të përshkruara në mënyrë të qartë përgjegjësitë e punës. Në mbështetje të kapaciteteve të stafit, si pjesë e vizionit të stafit udhëheqës është përfshirë edhe mbajtja e vazhdueshme e trajnimeve dhe vizitave studimore.



INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

KËSHILLI DREJTUES

DREJTORI

Zyrtar Ndërlidhës
dhe Ekzekutiv

Departamenti i Programeve

Departamenti për Administratë dhe Financa

Koordinatori i Programit

Drejtori Administrativ Financiar

Udhëheqësi i
Programit për
Trajtime e të
Vazhdueshme

Udhëheqësi i
Programit për
Trajnim
Fillestar

Zyrtar i Lartë
për Trajtime

Zyrtar i Lartë
për Trajtime

Udhëheqësi i Programit
Trajnues për Avancim dhe
profesionist të tjerë të
identifikuar nga IGJK.

Udhëheqësi i
Programit për
Hulumtime
dhe Publikime

Trajnues i Përhershëm (2)

Përkthimi (4)

Zyrtar për Vlerësim
dhe Statistika

Zyrtar i Lartë
për Teknologji
Informative

Asistent
administrativ

Drejtnes
Makine-
Shtëpiak

Asistent Teknik
/Logjistikë

Menaxher i
Prokurimit

Zyrtar i Lartë
për Buxhet dhe
Financa

Zyrtar për
Personel



6 BUXHETI

Burim kryesor financiar i IGJK-së është buxheti i Republikës së Kosovës. Buxheti vjetor i IGJK-së menaxhohet në mënyrë të pavarur sipas planifikimeve të bëra për çdo kategori ekonomike, duke u mbështetur në programin vjetor të punës. Procesi i kërkesës dhe raportit buxhetor realizohet përmes autoriteteve menaxheriale të IGJK-së. Krahas buxhetit shtetëror, që nga themelimi, IGJK ka realizuar mbështetje të vazhdueshme nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtar duke realizuar projekte të shumta, fokusi i të cilave ka qenë ngritja e kapaciteteve në gjyqësor dhe në vet IGJK-në (organet drejtuese dhe stafin). Fondet e donatorëve kryesisht menaxhohen nga donatorët, ndërsa IGJK përfiton mbështetje të drejtpërdrejt në ekspertizë, shkëmbim të përvojave, pajisje të teknologjisë informative, publikime apo shërbime të karakterit intelektual.



kji

Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute



7 ORGANIZIMI I TRAJNIMEVE

Që trajnimet e organizuara në IGJK të mund të shfrytëzohen nga të gjithë përfituesit e caktuar, që të bëhen planifikimet adekuatë për numrin e përfituesve për secilin trajnim dhe që ata përfitues të marrin pjesë në trajnimet me interes për ta, IGJK ka krijuar mekanizma të shumtë për të siguruar pjesëmarrjen në trajnime.

7.1. Kush përfiton nga trajnimet

Nga trajnimet e organizuar në IGJK, përfitues të drejtpërdrejtë janë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës, kandidatët potencial për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët e kanë kaluar me sukses provimin përgatitor të organizuar nga IGJK, si dhe profesionistët tjerë nga lëmi i gjyqësisë dhe prokurorisë (gjyqtarët porotë, stafi i gjykatave dhe prokurorive) të identifikuar nga IGJK. Në raste të caktuara, në trajnimet e vazhdueshme përfitues janë edhe profesionistë nga lëmi i drejtësisë puna e të cilëve është e lidhur ngushtë me atë të



gjykatave dhe prokurorive (avokatë, zyrtarë policorë dhe doganierë, zyrtarë nga shërbimi sprovues etj).

7.2. Identifikimi i nevojave për trajnime

IGJK në veçanti fokusohet që trajnimet e ofruara të plotësojnë kërkesat dhe nevojat e përfituesve të tij. Është një angazhim i përhershëm i IGJK-së që të përmirësoj mekanizmat për identifikimin e nevojave trajnuese të cilat përfshihen në kuadër të Programit të Punës.

Për hartimin e programit të punës IGJK përdorë por nuk kufizohet në mekanizmat si më poshtë:



- Pyetësorët e vlerësimit të trajnimeve pas secilit sesion trajnues;
- Pyetësorët për vlerësimin e nevojave të plotësuar nga gjyqtarët dhe prokurorët;
- Rekomandimet e KGJK, KPK, Gjykatës Supreme, Prokurorisë së Shtetit, Shoqatës së Gjyqtarëve dhe Shoqatës së Prokurorëve;
- Takimet me gjyqtarë dhe prokurorë, kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive;
- Rekomandimet e institucioneve dhe organizatave vendore e ndërkombëtare;
- Propozimet e trajnuesve të IGJK-së;
- Raportet e Punës të Gjykatave dhe Prokurorive;
- Rekomandimet e Zyrës për Vlerësim të Performances së gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Analiza e agjendës së institucioneve për hartim dhe amendamentim të ligjeve;
- Hulmimi i programeve të institucioneve trajnuese regjionale dhe ndërkombëtare;
- Propozimet e stafit, Këshillit Programor dhe Këshillit Drejtues të IGJK-së;
- Analiza e mekanizmave për vlerësim të efektit të trajnimeve;
- Strategjitë dhe dokumentet e miratuara nga institucionet të cilat përmbajnë rekomandime për gjyqësorin dhe sundimin e ligjit;
- Monitorimi e medieve të shkruara dhe elektronike.

7.3. Pjesëmarrja në trajnime

Mundësia e pjesëmarrjes në trajnime varet nëse ato janë trajnime të vazhdueshme apo fillestare.

IGJK ofron mundësi të barabarta për trajnim të vazhdueshëm dhe për avancim të të gjithë atyre të cilët konsiderojnë se ato trajnime janë me interes për ta. Ndërsa pjesëmarrja në trajnimin fillestar është e hapur vetëm për kandidatët të cilët me sukses e kalojnë provimin përgatitor dhe kanë për qëllim të bëhen gjyqtarë apo prokurorë. Ofrimi i trajnimeve të specializuara dhe shërbimeve të karakterit profesional si botimet dhe hulumtimet për zhvillimin e gjyqësisë, janë gjithashtu pjesë e misionit të IGJK-së.

Në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrje adekuate në numër dhe kompetencë, IGJK ka zhvilluar mekanizma të cilët kanë krijuar një sistem të ofrimit të mundësive për pjesëmarrje në trajnime të vazhdueshme dhe ato për avancim, ndërsa pjesëmarrja në trajnimin fillestar është e obligueshme.

7.3.1. Mënyrat e pjesëmarrjes në trajnime të vazhdueshme dhe për avancim

Me qëllim të koordinimit të pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnime të

vazhdueshme dhe për avancim, IGJK organizon takime të rregullta, me kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive, të nivelit themelor dhe të apelit.

Kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive e konsultojnë kalendarin e trajnimeve së bashku me gjyqtarë dhe prokurorë dhe duke marrë parasysh nevojat e tyre të shprehura përmes formularëve për aplikim i propozojnë IGJK-së listën e pjesëmarrësve. Pas vlerësimit përfundimtar nga ana e IGJK-së, lista e pjesëmarrësve finalizohet dhe gjyqtarët e prokurorët ftohen për trajnime përmes kryetarëve të gjykatave apo kryeprokurorëve të prokurorive. Në trajnimet ku marrin pjesë edhe profesionistë të tjerë nga lëmi i gjyqësisë të identifikuar nga IGJK, ata ftohen përmes eporëve të tyre.

7.3.2. Aplikimi online

Me qëllim të lehtësimit të pjesëmarrjes në trajnime IGJK ka krijuar mundësi që përfituesit e trajnimit të vazhdueshëm të aplikojnë online për trajnimet të cilat i konsiderojnë me interes për ta. Me këtë rast të interesuarit do të futen në listë të pjesëmarrësve pas konsultimit me kryetarë të gjykatave dhe kryeprokurorë të prokurorive.

Aplikimi online mund të bëhet në këtë link:



<http://igjk.rks-gov.net>

7.4. Ftesa për pjesëmarrje në trajnim të vazhdueshëm

Ftesa për pjesëmarrje në trajnim të vazhdueshëm dërgohet nga IGJK tek pjesëmarrësit jo më vonë se një muaj para mbajtjes së trajnimit. Të ftuarit janë të obliguar të konfirmojnë pjesëmarrjen përmes kryetarëve të gjykatave, kryeprokurorëve të prokurorive apo drejtpërdrejtë në IGJK.

7.5. Apaguhet për trajnime?

Të gjitha trajnimet e vazhdueshme dhe ato për avancim ofrohen pa pagesë nga IGJK. Gjithashtu, pjesëmarrësve në këto trajnime u ofrohet ushqimi dhe pijet pa pagesë. Këto shërbime ofrohen si pjesë e buxhetit të aprovuar për organizim të trajnimeve nga IGJK dhe janë pjesë e praktikave ndërkombëtare në këtë fushë.

Në trajnimin fillestar kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë nuk paguajnë asnjë shërbim, përveç ushqimit për veten e tyre. Megjithatë IGJK në bazë të ligjit është e obliguar që tua paguaj një honorar kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët ndjekin këtë trajnim.



8 STRUKTURA E TRAJNIMEVE

Me qëllim të përmbushjes së mandatit ligjor, IGJK ka krijuar një strukturë organizative programore e cila i përgjigjet nivelit të përfituesve të tyre.

Aktivitetet trajnuese të IGJK-së realizohen në kuadër të programeve të ndryshme si më poshtë: *Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)*, *Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)*, *Programi i Trajnimit për Avancim (PTA)* dhe *Programi për Hulumtime dhe Publikime (PHP)*. IGJK gjithashtu zhvillon kapacitetet e trajnuesve të vet përmes *Programit të Trajnimit për Trajnues*, si dhe zbaton vizita studimore, programe praktike (intershipi) brenda dhe jashtë vendit, konferenca dhe aktivitete të tjera.

8.1. Trajnimi i vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë

Trajnimin e vazhdueshëm IGJK e organizon përmes Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV). Ky program përfshinë organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme për gjyqtarë dhe prokurorë me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe etike si dhe forcimin e shkathtësive të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre.

IGJK, organizon trajnimin e vazhdueshëm që nga viti 2000 kur edhe është themeluar duke zhvilluar vazhdimisht kapacitetet organizative dhe metodologjinë trajnuese. Bazuar në përvojat e deritashme, në IGJK është arritur një kulturë e avancimit të vazhdueshëm të strukturës programore dhe metodologjisë së zbatimit të aktiviteteve trajnuese në kuadër të PTV.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo

Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute

**PROGRAMI PËR PËRGATITJEN E KANDIDATËVE PËR GJYQTAR
 PROKURORË**

**PROGRAM ZA PRIPREMI KANDIDATA ZA SUDIJE I TUŽIOČ
 E FOR THE CANDIDATES FOR JUDGES**

rsyetimi ligjor & shkathësitë e
 hartimit për gjykatësit





USA
 NGA POPULLI AMERIKAN
 OD AMERICKOG NARODA

**EFFECTIVE RULE OF
 LAW PROGRAM**
**PROGRAMI PËR SUND
 E FEFKIVTË LIGJ
 PROGRAM ZA EFEKTIV
 VLADAVINU PRAVOSUDJE**



z. Albert Zogaj,
 Gjykatat Themelore në Prishtinë,
 Departamenti i Përgjithshëm



8.1.1 Cilat fusha mbulohen nga PTV?

Në kuadër të PTV-së trajtohen çështje nga:


- E drejta penale (materiale, procedurale dhe ekzekutimi i sanksioneve penale);
- E drejta civile materiale dhe procedurale me të gjithë ndarjet e fushës;
- Drejtësia për Fëmijë;
- E drejta komerciale dhe financiare;
- E drejta administrative;

- E drejta evropiane dhe ndërkombëtare;
- Të Drejtat e Njeriut, barazia gjinore dhe mosdiskriminimi;
- Aspekte materiale dhe procedurale nga lëmia e kundërvajtjeve;

Gjithashtu PTV përmban programe trajnimi të veçanta si ato për etikën, menaxhimin e rasteve, komunikimin, zhvillimin e shkathtësive të gjyqimit, gjuhët e huaja, shkrimi dhe arsyetimi ligjor, etj.

8.1.2 Aktivitetet e realizuara në PTV 2000 -2013

Aktivitetet e realizuara në PTV 2000-2013*



* 2013 - përfshinë aktivitetet e realizuara deri në muajin Tetor

8.2. Programi i Trajnimit Fillestar

Përgatitja paraprake e personave që pretendojnë të bëhen gjyqtarë apo prokurorë është e një rëndësie të veçantë. Trendët e sotme tregojnë se gati të gjitha vendet e regjionit dhe shumë vende të Evropës dhe Botës aplikojnë këtë lloj trajnimi. Trajnimi fillestar për kandidatët për gjyqtarë e prokurorë para se ata të fillojnë ushtrimin e funksioneve të tyre, konsiderohet si një prej faktorëve kyç në garantimin e pavarësisë, paanshmërisë dhe kompetencës profesionale e etike të gjyqësorit.

Në Kosovë trajnimi paraprak i kandidatëve njihet me emrin Programi i Trajnimit Fillestar (PTF). Ky program organizon trajnim fillestar dhe aktivitete të ndryshme për kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm.

Programi i Trajnimit Fillestar (PTF), ka zhvilluar kurrikula dhe metodologji trajnimi adekuate në mbështetje të ngritjes së shkathtësive teorike e praktike të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Përmbajtja dhe struktura e PTF është ndërtuar me qëllim të plotësimit të njohurive të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të fituara në kualifikimet e mëparshme, me qëllim të përgatitjes së tyre për të ushtruar me sukses funksionet pas emërimit.

Gjatë hartimit dhe zbatimit të PTF shfrytëzohen të gjitha resurset me qëllim të përgatitjes profesionale, interdisiplinare dhe personale të grupeve të kandidatëve në mënyrë që të fitojë aftësi dhe të zotërojnë shkathtësi të gjithanshme për ushtrimin e përgjegjësisë të gjyqarit apo prokurorit.



8.2.1. Kush mund të ndjek trajnimin fillestar?

Trajnimin fillestar të organizuar nga IGJK mund ta ndjekin vetëm kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj. Para se dikush të konsiderohet kandidat potencial për gjyqtarë apo prokurorë duhet që me sukses të kalojë Provimin Përgatitor.

8.2.2. Provimi Përgatitor si kusht për të ndjekur trajnimin fillestar

Në bazë të ligjit (ligji Nr. 02/L-25, nenet 2.1. b dhe 7), IGJK është përgjegjëse për organizimin dhe vlerësimin e Provimit Përgatitor për kandidatët potencial për gjyqtarë dhe prokurorë.

Procesi i organizimit dhe administrimit të Provimit Përgatitor bëhet nga IGJK në bashkëpunim dhe koordinim me KGJK dhe KPK. Hartimi dhe Vlerësimi i Provimit Përgatitor bëhet nga një komision përbërja e të cilit miratohet nga Këshilli Drejtues i IGJK-së. Struktura dhe rregullat e organizimit të këtij provimi bëhet nga Këshilli Programor i IGJK-së. Provimi Përgatitor është parakusht për fillimin e trajnimeve në PTF dhe kalimin e këtij provimi mund ta bëjnë vetëm kandidatët me rezultatet më të larta, të cilët janë në kuadër të numrit të kërkuar nga KGJK dhe KPK për trajnim. Ky provim siguron një grup të kualifikuar të kandidatëve të cilët më pas do

të ndjekin PTF në përgatitje për tu emëruar si gjyqtarë apo prokurorë.

8.2.3. Struktura e Programit të Trajnimit Fillestar

Programi i Trajnimit Fillestar (PTF) që nga fillimi ishte realizuar në tri faza. Megjithatë periudha kohore dhe modulet e këtij programi kanë shënuar një zhvillim dhe rritje të vazhdueshme.

Programi i trajnimit fillestar është i ndarë në tri faza. Dy fazat e para përfshijnë trajnime teorike dhe praktike (prezantime, shqyrtime të rasteve nga praktika gjyqësore, simulime etj) të kombinuara me vizita dhe trajnime praktike në institucionet e drejtësisë në vend. Faza e tretë është e përbërë tërësisht me trajnime praktike në gjykata dhe prokurori (faza e mentorimit).

- Faza e parë zgjatë 5 muaj, ku kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë trajnohen së bashku;
- Faza e dytë zgjatë 3 muaj dhe në këtë fazë trajnohen ndaras kandidatët për gjyqtarë nga ata për prokurorë;
- Faza e tretë zgjatë 8 muaj. Në këtë periudhë kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë caktohen në gjykata dhe prokurori, ku ushtrojnë punë praktike nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre (gjyqtarë/prokurorë).

Realizimi i PTF sipas programit trajnues 2013/2014 bazohet në 60 module (programe trajnuese). Në përfundim të PTF kandidatët i nënshtrohen provimit përfundimtarë. Numri i kandidatëve në

PTF, përcaktohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nevojave për gjyqtarë dhe prokurorë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.




8.2.4. Numri i kandidatëve që kanë diplomuar në PTF

Nga fillimi i zbatimit të PTF e deri më tani kanë diplomuar katër (4) gjenerata të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Këtij procesi i ka paraprirë pilot projekti i PTF i organizuar në vitin 2005 i cili ka zgjatur tre muaj dhe përfshinte 15 module trajnuese. Gjeneratës së këtij pilot programi i janë nënshtruar 60 kandidatë. Nga viti 2008 kur ka filluar

të zbatohet PTF, trajnimin fillestar e kanë përfunduar me sukses 141 kandidatë, ku 127 prej tyre janë emëruar si gjyqtar apo prokuror. Në kohën e përgatitjes së këtij publikimi janë duke u zhvilluar përgatitjet që të fillojë trajnimi fillestar edhe për gjeneratën e pestë ku do të trajnohen 34 kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë.

Grafikoni në vazhdim paraqet të dhënat për këto katër gjenerata:

Numri i kandidatëve që kanë diplomuar në PTF



8.3. Programi i Trajnimeve për Avancim

Programi i Trajnimeve për Avancim (PTA) i dedikohet gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapo emëruar dhe atyre të cilët janë avancuar apo kanë ndërruar nivelet dhe funksionet brenda gjykatave dhe prokurorive.

Qëllimi i PTA është mbështetja e gjyqtarëve dhe prokurorëve në ngritjen dhe aftësimin e tyre profesional dhe ndërdisiplinor për zbatimin efektiv dhe të drejtë të dispozitave ligjore dhe praktikave

më të mira për standardizim dhe unifikim.

PTA është program i veçantë trajnimi, kurrikula e të cilit, konsiderohet si komplementar i PTV-së, në kuadër të së cilit organizohen trajnime specifike në mbështetje të kategorive përfituese të përcaktuara sipas ligjit.

Ky program trajnimi ka filluar të zbatohet nga viti 2010, dhe deri më sot ka evoluar dhe është plotësuar varësisht prej nevojave, si shprehje e ndryshimeve në legjislacion dhe në sistemin gjyqësor e prokurorial.




8.3.1. Cilat fusha mbulohen nga PTA?

PTA krahas moduleve që trajtojnë tema profesionale duke iu përshtatur nevojave të departamenteve të strukturës së re të gjykatave dhe prokurorive, legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar, përmban edhe module të cilat mbështesin ngritjen e shkathtësive të veçanta të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Këto module trajnuese kanë të bëjnë me organizimin e punës, komunikimin, përgatitjen për shqyrtim gjyqësor, përfaqësimin e rasteve në gjykim, menaxhimin e rasteve, menaxhimin e gjykatës etj.

8.3.2. Trajnimet e realizuara në PTA 2010-2013

Trajnimet e realizuara në PTA 2010-2013*



* 2013 - përfshinë trajnimet e realizuara deri në muajin Tetor

8.4. Programi për Hulumtime dhe Publikime

Krahas trajnimit fillestar, të vazhdueshëm dhe për avancim edhe aktivitetet profesionale si, hulumtimi për çështje të ndryshme në gjyqësi dhe ofrimi i burimeve të nevojshme ligjore, konsiderohen komponentë e rëndësishme në zhvillimin e profesionalizmit, paanësisë dhe pavarësisë së kapaciteteve të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Baza që IGJK të realizojë hulumtime mbështetet në ligjin mbi IGJK-në. Ky ligj përcakton që IGJK krahas aktiviteteve trajnuese është edhe një institucion profesional – kërkimor, për zhvillimin e gjyqësisë në vend (Ligji Nr. 02/L-25, neni 2, parag. 2.2. nën b.). Në kohën e përgatitjes së këtij publikimi, IGJK, është në proces të modernizimit të bibliotekës së vet dhe pasurimit me materiale ligjore të besueshme dhe aktuale në formë elektronike dhe kopje fizike.

Programi për Hulumtime dhe Publikime synon që përfituesve të IGJK-së t'i ofrojë mbështetje praktike dhe teknike për hulumtim, qasje në burime të ndryshme ligjore pa përjashtuar dhe mundësinë e publikimit të rezultateve të hulumtimeve të tilla. Në këtë drejtim ofrohet mbështetje efikase dhe profesionale si dhe qasje në informacione të besueshme përmes përdorimit të teknologjisë moderne dhe mirëmbajtjes së materialeve të mjaftueshme.



Republika e Kosovës
 Republika Kosovo
 Republic of Kosovo



Kosovo Judicial Institute
 Institut Gjyqësor i Kosovës
 Kosovski Institut za Pravo i Sudstvo

JUSTICIA

Prvotni Nalozhi Golepja Kandidatata Programi Pevetnje Obekte za Prerovsuhno Ofrmoqevitje



Godimall, Broj 1/2010



Kosovo Judicial Institute
 Institut Gjyqësor i Kosovës
 Kosovski Institut za Pravo i Sudstvo

Prvotni Nalozhi Golepja Kandidatata Programi Pevetnje Obekte za Prerovsuhno Ofrmoqevitje

JUSTICIA

Viti 1/2009, Numri 1/2009



EVROPSKO ZAKONODAVSTVO
 JUSTICIA

8.4.1. Publikimet

Në kuadër të kontributit për zhvillimin e gjyqësisë në vend, si dhe për prezantimin e aktiviteteve të tij IGJK nxjerr publikime të ndryshme, si në vijim:

- **Justicia** – është një revistë shkencore me punimet e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë. Secili kandidatë dërgon një punim shkencor për botim para diplomimit.
- **Modulet** – IGJK publikon module trajnuese për fusha të ndryshme të së drejtës. Këto module shërbejnë për trajnimet që realizohen në IGJK.
- **Manuale** – Për ngritjen e performancës së trajnimeve janë botuar një mori manualesh, si: Doracaku për Trajnues, Doracaku për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, Protokolli referues për institucionet e drejtësisë për fëmijë, Doracaku për Mentorët e PTF.
- **Broshura** – për të krijuar mundësi që qytetarët të jenë të informuar për drejtësinë dhe në të njëjtën kohë që profesionistët e sistemit gjyqësor e prokurorial të kenë mundësi të gjejnë

informacione bazike, IGJK nxjerr broshura të ndryshme. Ndër broshurat e nxjerra janë: Të Drejtat Pronësore të Grave në Kosovë, Arsimit Ligjor për Drejtësi, etj.

- **Buletini** – IGJK nxjerrë buletinin mujor ku përshkruhen të gjitha aktivitetet e realizuara në atë periudhë.
- **Raportet** – gjatë punës së vet IGJK publikon raporte të ndryshme periodike, përfshirë edhe Raportin Vjetor të Punës.

Në kuadër të PHP janë ndërmarrë një numër iniciativash për publikime. Ndër më të rëndësishmet është revista e karakterit shkencor që do të nxirret nga IGJK. Në këtë revistë do të mund të publikohen punime me karakter shkencorë, nga gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë të së drejtës dhe në përgjithësi profesionistë puna e të cilëve është me interes për zhvillimin e drejtësisë në vend.

Po ashtu IGJK është në fazën e përgatitjeve për hartim dhe publikim të manualeve (bench books) për lëmitë kryesore të së drejtës (penale, civile dhe administrative).

8.5. Trajnimi i profesionistëve të sistemit gjyqësor e prokurorial

Mbështetur në mandatin e tij, IGJK zhvillon programe trajnimi me qëllim të ngritjes së shkathtësive profesionale të profesionistëve tjerë të cilët për shkak të natyrës dhe funksionit të tyre, janë pjesë dhe kontribuojnë drejtpërdrejtë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Përveç gjyqtarëve porotë dhe bashkëpunëtorëve profesional të gjykatave dhe prokurorive për të cilët hartohen programe të veçanta trajnimi, IGJK i kushton vëmendje të posaçme edhe profesionistëve në sistemin e drejtësisë, puna e të cilëve është e lidhur me gjykata dhe prokurori. Këta profesionistë marrin pjesë në trajnimet e organizuara në kuadër të PTV-së atëherë kur trajtohen tema të cilat drejtpërdrejt prekin në funksionet e tyre.



8.6. E-learning

Mësimi në distancë (e-learning) është të mësuarit interaktiv në distancë duke shfrytëzuar teknologjinë elektronike online, jashtë një salle trajnimi tradicionale.

IGJK ka zhvilluar një platformë të mëimit në distancë e cila do të përmbushë të gjitha kërkesat për trajnime, përparësitë kryesore të së cilës janë

kursimi dhe përshtatja e kohës si dhe cilësia e lartë e trajnimeve.

Kjo metodologji trajnimi e cila tani gjen zbatim të gjerë në institucionet trajnuese më të zhvilluara, do të sigurojë përfshirje të gjerë të pjesëmarrësve në trajnimet online si dhe do të jetë në dispozicion të përfituesve të IGJK-së për një kohë të gjatë, me synim rritjen e efikasitetit të trajnimeve.



8.7. Trajnimet dhe programet jashtë vendit

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve, kandidatëve për gjyqtarë e prokurorë si dhe profesionistëve të tjerë nga lëmi i gjyqësisë, IGJK në bashkëpunim me donatorët, organizon trajnime të shumta dhe vizita studimore në institucione të këtyre vendeve. Njohja me praktikat më të mira të shteteve të zhvilluara dhe shkëmbimi i përvojave janë përmbajtje kryesore e këtyre aktiviteteve.

8.8. Metodologjia e trajnimeve

Për realizimin e trajnimeve me një metodologji bashkëkohore, IGJK ka në fokus të veçantë ngritjen e kapaciteteve të trajnuesve. Në këtë drejtim, vazhdimisht organizohen trajnime për trajnues në mënyrë që ata të aplikojnë teknikat më të avancuara të trajnimit.

Një numër i trajnimeve për trajnues shfrytëzohen

edhe për hartimin e draft programit të trajnimeve dhe moduleve të caktuara trajnuese. Kjo qasje zbatohet me qëllim që trajnuesit të përfshihen si në identifikimin e nevojave për trajnim, ashtu edhe në metodologjinë për zbatim të programeve trajnuese.

Zhvillimi i metodologjisë së trajnimeve është mbështetur edhe nga rregulla të veçanta të përzgjedhjes për trajnues të IGJK-së si dhe në doracakun për trajnues dhe mentor të IGJK-së.

8.9. Trajnuesit (përzgjedhja e tyre)

Trajnues në IGJK mund të jenë gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë të së drejtës dhe specialistë të fushave të ndryshme (varësisht nga përmbajtja e programit trajnues) me interes për përfituesit e IGJK-së. Trajnuesit në IGJK janë vendor dhe ndërkombëtarë.

Kushtet për përzgjedhjen e trajnuesve përcaktohen me “Rregullat për zgjedhjen e trajnuesve të përkohshëm të IGJK-së”.



9 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE NË KOSOVË DHE JASHTË SAJ

Në përmbushje të misionit, IGJK është e përkushtuar që të punojë së bashku me institucionet dhe organizatat vendore si dhe partnerët ndërkombëtarë të cilët ndajnë objektiva të njëjta.

Duke marrë parasysh nevojat në rritje për profesionistë dhe ndryshimet e vazhdueshme në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, IGJK ka ndërtuar një partneritet efektiv dhe të qëndrueshëm me institucione vendore dhe ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe jashtë saj.

Bashkëpunimi me partnerë vendor dhe ndërkombëtar është shprehur përmes nënshkrimit të marrëveshjeve të shumta bilaterale dhe multilaterale, pjesëmarrjes aktive në nismat rajonale me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe

realizimit të aktiviteteve në fushat e interesit të përbashkët. Pjesë e këtij bashkëpunimi janë edhe organizimi i programeve praktike brenda dhe jashtë vendit për përfituesit e IGJK-së.



10 DONATORËT

Mbështetja e partnerëve ndërkombëtarë ka ndihmuar ngritjen e kapaciteteve të IGJK-së dhe ka ofruar mundësitë për një vetë-qëndrueshmëri në disa programe, përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira. Trajnimet dhe programet praktike për menaxhmentin, personelin dhe trajnuesit, ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e kapaciteteve udhëheqëse dhe organizative, pa lënë

anash zhvillimin e metodologjisë trajnuese dhe infrastrukturën teknike. Gjithashtu një pjesë e mbështetjes ishte fokusuar drejtpërdrejtë në trajnimin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe kandidatëve për këto funksione. Ndërsa pritjet për vazhdim të kësaj mbështetjeje janë premtuese të paktën edhe për një periudhë afatshkurtër.



11 IDETË

PËR PËRMIRËSIMIN E PROGRAMEVE APO NEVOJA PËR PUBLIKIM

IGJK është shumë e përkushtuar në ofrimin e trajnimeve të një cilësie të lartë dhe në hap me zhvillimet më bashkëkohore të mësimdhënies për të rritur. Përfituesit e IGJK-së mund të propozojnë tema për trajnimet e ardhshme apo ide për përmirësimin e trajnimeve dhe të trajnuesve në formularët e vlerësimit që shpërndahen për çdo

trajnim, e të cilat analizohen me kujdes të veçantë.

Po ashtu këto propozime mund të bëhen duke shfrytëzuar mundësitë e krijuara nga IGJK si ueb faqja, platforma e-learning, platforma e bibliotekës elektronike si dhe të kontaktojnë në çdo kohë stafin e IGJK-së përgjegjës për programe trajnuese.



Kontakti

Për më shumë informata kontaktoni:
Instituti Gjyqësor i Kosovës
Rr. "Muharrem Fejza" p.n. - Prishtinë

Tel. +381 38 200 18 660

web: <http://igjk.rks-gov.net>

Dërgo pyetjet apo komentet tuaja në
e-mail adresën infokji@rks-gov.net

